



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Nr. 33-BD/2025
Prishtinë: 24.06.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nën paragrafi 5.13 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, dhe në mbështetje të nenit 56 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 24.06.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet vendimi për pagesë jashtë orarit të punës për stafin e administratës së Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës bazuar në dokumentin bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pilana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

PROPOZIM PËR PAGESË JASHTË ORARIT TË PUNËS PËR STAFIN E ADMINISTRATËS SË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Drejtuar: Bordit Drejtues të OIRK-së

Data: 24.06.2025

Te nderuar,

Në bazë të Nenit 56 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, që rregullon të drejtën për pagë shtesë për punën jashtë orarit të punës, si dhe në përputhje me kontratat individuale të punës dhe aktet e brendshme të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK), ju paraqitet për shqyrtim dhe aprovim ky propozim për kompensimin e stafit të administratës që angazhohet jashtë orarit të rregullt të punës.

1. Qëllimi i Propozimit

Ky propozim ka për qëllim të sigurojë kompensim të drejtë dhe në përputhje me ligjin për angazhimin shtesë të stafit të administratës së OIRK-së gjatë periudhave të ngarkesës së shtuar, përfshirë orët jashtë orarit, fundjavat dhe ditët e festave zyrtare.

2. Baza Ligjore

Ky propozim mbështetet në Nenin 56 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, i cili përcakton se:

- Për punë jashtë orarit, punonjësit i takon **30% shtesë në orë** mbi pagën bazë;
- Për punë gjatë fundjavave dhe festave zyrtare, punonjësit i takon **50% shtesë në orë**;
- Punonjësit mund të kërkojnë kompensim në ditë pushimi në vend të pagesës shtesë, në përputhje me ligjin dhe kontratat përkatëse;
- Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë e punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e përcaktuara në ligj.

3. Zbatimi në OIRK

Propozohet që për çdo orë pune të kryer jashtë orarit të rregullt të punës, stafi i administratës së OIRK-së të kompensohet si vijon:

- **30% shtesë në orë** për punë jashtë orarit të rregullt të punës;
- **50% shtesë në orë** për punë gjatë fundjavës;
- **50% shtesë në orë** për punë në ditët e festave zyrtare.

Kompensimi do të realizohet në formë financiare ose, në marrëveshje me punonjësin, përmes ditëve pushim ekuivalente, në përputhje me përqindjet e përcaktuara në ligj.

4. Procedura e Zbatimit

- Orët shtesë do të evidentohen dhe konfirmohen nga **Drejtori Ekzekutiv i OIRK-së**;
- Pagesat për orët shtesë do të përfshihen në **pagën mujore të muajit vijues**;
- Në rast të kompensimit me pushim, orët do të shndërrohen në ditë pushimi përkatëse sipas rregullave ligjore.

5. Përfundim

Ky propozim synon të përmbushë obligimet ligjore të institucionit dhe të sigurojë motivim dhe shpërblim të drejtë për punonjësit e administratës që angazhohen jashtë orarit të rregullt të punës. Duke pasur parasysh rëndësinë e funksionimit efikas dhe të pandërprerë të OIRK-së, kërkojmë **miratimin e këtij propozimi nga ana e Bordit Drejtues**.

Përgatiti:

Lulzim Ismajli
Drejtori Ekzekutiv